

VENDIM
Nr.1586, datë 3.12.2008

PËR TRANSFERIM FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, dhe të nenit 21 të ligjit nr.9620, datë 9.11.2006 “Për dhomat e tregtisë dhe të industrisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, të bëhen:

a) rishpërndarja e fondit 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë, nga programi “Mbështetje për zhvillim ekonomik”, zëri “Shpenzime kapitale të brendshme”, në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, zëri “Transferta korrente të brendshme”;

b) pakësimi i fondit 44 500 000 (dyzet e katër milionë e pesëqind mijë) lekë, nga programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, zëri “Transferta korrente të brendshme”.

2. Lejimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ta transferojë fondin 44 500 000 (dyzet e katër milionë e pesëqind mijë) lekë në llogarinë e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe të Industrisë së Shqipërisë.

3. Ky fond do të përdoret për organizimin nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe të Industrisë të Shqipërisë, gjatë vitit 2009, të një forumi ndërkombëtar, për promovimin e investimeve të huaja në Shqipëri.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha